

Kuadri i bashkepunimit per reformen zgjedhore

1. Formohet Keshilli Politik me perfaqesues te opozites dhe drejtuesve te komisionit te reformes zgjedhore dhe perfaqesueseve te grupeve parlamentare ne Kuvend.

2. Keshilli mblidhet brenda Janarit 2020 dhe autorizon platformen e punes se procesit te reformes zgjedhore si me poshte:

- Nje perfaqesi politike (2 persona) nga opozita jashteparlamentare dhe eksperte do te punojne me dy bashke-kryetaret e Komisionit te Reformes Zgjedhore dhe ekspertet e atashuar prane tij;

-Ceshtjet qe do adresohen percaktohen ne vendimin e Kuvendit Nr.102/2017, i amenduar, "Per ngritjen e komisionit te reformes zgjedhore " perfshire dhe planin e punes te miratuar me konsensus nga komisioni ne vitin 2017, si dhe çdo problematike tjeter zgjedhore qe palet bien dakord me konsensus me qellim arritjen e standarteve zgjedhore nderkombetare.

- Palet e perfshira angazhohen te adresojne me konsensus te gjitha ceshtjet e administrimit te zgjedhjeve objekt i punes se komisionit te reformes zgjedhore , perfshire rekomandimet e OSBE/ODHIR dhe per ceshtjet te cilat nuk gjendet dakordesi do te kerkoet mendim dhe asistence nga ekspertiza nderkombetare e OSBE/ODHIR me qellim gjetjen e nje zgjidhje te pranueshme.

- Per te ndihmuar ne kete proces Komsioni i Reformes Zgjedhore do te kerkoje zyrtarisht asistencen e OSBE/ODHIR perfshire dhe dergimin e eksperteve, nese kjo eshte e mundur, qe do te bashkepunojne me perfaqesuesit politike dhe ekspertet e percaktuar ne paragrafin e dyte te kesaj pike, me qellim per te lehtesuar procesin e diskutimit dhe hartimit te projektpropozimeve perkatese.

-Projekti perfundimtar i dakordesuar mes paleve sipas ketij dokumenti, do te miratohet nga Kuvendi ne perputhje me procedurat parlamentare. Shumica angazhohet qe te mos kryeje ndryshime ne komisionin e reformes zgjedhore dhe ne seance plenare ne tekstin e miratuar dhe dakordesuar mes paleve sipas ketij dokumenti.

-Palet angazhohen qe reforma te perfundoje jo me vone se 15 Mars 2020.